

Policimi komunitar: filozofi e policisë të së ardhmes

Arqile Kosta

Abstrakt

Policimi komunitar i ka rrënjët tek vendosja e mirëbesimit dhe kredibilitetit të ndërsjelltë midis Policisë dhe Komunitetit. Për të mbajtur një nivel të lartë të cilësisë së marrëdhënieve, të gjitha rastet dhe veprimet e policisë ndaj nevojave të komunitetit, qofshin të karakterit proaktiv apo reagues, duhet të plotësojnë standarde të larta të disiplinës së punës, të repektimit të ligjit, paanësisë, drejtësisë dhe profesionalizmit. Personeli i policisë që përfshihet në projektet e policimit komunitar duhet të përzgjidhet me kujdesin më të madh dhe të përgatitet me cilësi për të demonstruar kompetencë për shërbimet që do të përgjigjet. Implementimi i Policimit Komunitar ka të domosdoshme ndryshime dhe reformime themelore në strukturën dhe në manaxhimin e policisë. Ai ndryshon nga policimi tradicional në mënyrën si e percepton komuniteti dhe në zgjerimin që pësojnë qëllimet dhe objektivat e tij. Ndërkohë që mbajtja nën kontroll dhe parandalimi i krimit mbeten prioritete, policimi komunitar, si një strategji e re, përdor një gamë të gjerë metodash e programesh për të realizuar qëllimet e veta.

Hyrje

Rruga e shoqërisë shqiptare drejt Europës është e mbushur me një numur problemesh të shtruar për zgjidhje. Ato fillojnë me mënjanimin e stereotipeve dhe metodave të vjetra të policimit, deri tek nevojat e përvetësimit dhe zbatimit të prioriteteve të filozofisë demokratike të policimit komunitar. Shndërrimi i të Drejtave Universale të Njeriut në qëllime strategjike të Policisë së Shtetit; transparenca, hapja dhe llogaridhënia e saj për kryerjen e detyrave institucionale dhe vendosja plotësisht e veprimtarisë të të gjithë punonjësve dhe strukturave policore nën qeverisjen e Ligjit, janë disa nga faktorët e qënësishëm që e bëjnë të arritshëm dhe të qëndrueshëm mirëkuptimin e besimit të komunitetit. Vetëm shoqëria, ku çdo qytetar e ndjen veten të sigurtë dhe të mbrojtur nga ligji, mund ta quajë veten një shoqëri të shëndetshme. Për këtë arsye, bashkëpunimi polici-publik, është një faktor vital i shtetit të së drejtës dhe kushti themelor për policimin demokratik.

Rezultatet e punës të policisë, përcaktohen në një shkallë të gjerë nga qëndrimi që mbajnë pjestarët e shoqërisë ndaj policëve të saj. Aftësia e policisë për të përmbushur detyrat e veta, varet nga miratimi që i bën publiku veprimeve të sjelljeve të punonjësve të policisë dhe nga aftësia e policisë për ta merituar respektin e publikut. Opinioni i publikut për policinë e vet nuk formohet me *“urdhër të peshkut”*, por mbështetet mbi përshtypjet që formohen ditë-pas-dite, duke vëzhguar e përjetuar veprimet, qëndrimet dhe cilësitë profesionale që manifestojnë të punonjësit konkretë të policisë ndaj qytetarëve dhe me njeri-tjetrin.

Duhet theksuar se tashmë janë bërë hapat e pra të një transformimi dhe është krijuar baza që garanton vijueshmërinë. Kjo demonstron, para së gjithash, përmes evoluimit që ka pësuar baza ligjore e normative e veprimtarisë dhe organizimit të policisë së shtetit; tek ndërtimi dhe aplikimi i një programi të gjithanëshëm të zhvillimit strategjik për transformimin në një shërbim publik e profesional; tek hartimi e përshtatja e standarteve të larta etike të detyrës; tek vendosja e një theksi të fortë në domosdoshmërinë e repektimit të standarteve kushtetuese për të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe tek zbatimi në nivel cilësisht të ri të vlerave, standardeve dhe normave të KE. Ligji për Policinë e Shtetit, ligji për gradat, si dhe

një numur aktesh të tjera ligjore e nënligjore, kanë zëvendësuar pothuaj të gjithë dokumentacionin e mëparëshëm normativ që rregullonte veprimatrinë, funksionimin dhe organizimin e policisë shqiptare. Në to, veç eksperiencave të reja të fituara gjatë periudhës së tranzicionit demokratik, janë përshtatur gjerësisht përvojat e policive europiane e më gjerë, me të cilat është bashkëpunuar gjerësisht përmes misionëve të INTERFORCE, MAPE, ECPA-A, PAMEKA dhe ICITAP.

Problemet komplekse, me të cilat po ndeshet Policia e Shtetit, kapërxehen më lehtë duke zgjeruar bashkëpunim me kolegëve tanë në Europë e në botë; duke ndërtuar marrëdhënie të ndërsjellta, të bazuara në themelet e filozofisë së demokracisë; ku secili partner merr përsipër përgjegjësitë dhe përpiqet t'i përmbushë brenda realiteteve të veta socialpolitike, ekonomike, morale e kulturore.

Sfondi i përgjithshëm shoqëror

Nëse qëllimet shumë të ndryshme të shërbimeve policore do t'i kalonin nëpër një lente fokusimi për t'i mbledhur në një pikë të vetme, imazhi që do të merrnim do të ishte "detyra për të mbajtur rendin dhe sigurinë publike, në mënyrë të qendrueshme, duke u bazuar në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive të qytetarëve të shpallura e të garantuara në Kushtetutë". Ajo që nuk lexohet tek një imazh i tillë është fakti se policia nuk mund dhe nuk mban e vetme përgjegjësinë për sigurinë dhe rendin në shoqëri, por e ndan atë me aktorët e tjerë shoqërorë, duke filluar nga individit dhe gjer tek çdo institucion shoqëror e shtetëror në çdo nivel të qeverisjes vendore e qendrore. Megjithatë, për shkak se krimi, konvencionl dhe i orgnizuar, përbën një kërcënim imediat e serioz për bashkësitë tona të brishta, Policia e Shtetit ka një rol më të dukshëm, madje primar në kapërximin e këtij rreziku imediat, si dhe të frikës e pasigurisë që përhapin këto veprimtari kriminale në komunitet e në opinionin publik.

Krimi i organizuar tashmë nuk është më një kategori thjesht ligjore, por një kategori sociale mjaft dinamike. Përballë kësaj tabloje të zymtë, policisë i vihen përballë dy alternativa:

1. *Ose ta përballojë problemin me ndërtimi dhe plikimin e strategjive të reja dhe efikase në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin, me strukturë e politikës vendimmarrëse e me të gjithë shoqërinë civile,*
2. *Ose ta anashkalojë këtë dukuri antisociale duke vazhduar të merret me "peshqit e vegjël" dhe me krimin konvencional.*

Përvoja tregon se shoqëritë ku veprimtaria kriminale është në rritje dhe krimi del jashtë kontrollit, parapëlqejnë që reformat në polici të bëhen të kufizuara ose i kundërshton, duke menduar se reformimi i policisë në momente të tilla do t'i sillte dëme sigurisë publike dhe mbajtjes nën kontroll të krimit.

Problemet që hasen

Shoqëria demokratike bashkëjeton natyrshëm me një tension të vazhdueshëm midis dëshirës për rend e qetësi dhe dëshirës për liri. Që të dyja këto dëshira janë thelbësore. Ndërkohë që, siç dëshmon rasti i shtetit policor e totalitar, e para mund të arrihet pa pasur të dytën, është e pamundur të kemi një shoqëri me liri të garantuara pa pasur një minimum të shkallës së rendit dhe qetësisë. Policimi demokratik orvatet të shmangë ekstremet e këtyre dëshirave, të anarkisë ku të çon një liri e shfrenuar dhe represionit të çon një rend i mbajtur me "dorë të fortë". Në një shoqëri demokratike, që respekton dinjitetin e qytetarëve individualë, vlerat e vullnetarizmit, konsensusin qytetar dhe zgjidhjet joviolente të konflikteve, policia, me mjetet dhe veprimet e saj, të mbështjella shpesh me një tis sekretit dhe me përdorim të forcës, duket si një anomali. Ajo dhe punonjësit e saj ngarkohen me ligj të përdorin mjete jodemokratike për të arritur qëllime e përfundime demokratike. Për të qëndruar brenda kufijve të ligjit dhe nevojës shoqërore për liri dhe dinitet human, shoqëria demokratike i vendos policisë dhe detyrave të saj kufij të qartë kompetencash. Megjithatë këto nuk janë të mjaftueshme për të garantuar liritë dhe të drejtat kushtetuese. Abraham Lincoln, e pohonte këtë dilemë kur pyeste, ..."na duhet një qeverisje e fortë për të

garantuar liritë e qytetarëve të vet apo një qeverisje e dobët që nuk dot garanton as egzistencën e saj?" Duke i nënkuptuar atributet e policisë brenda kësaj dileme, paradoksi mund të riformuloht: *shoqëria demokratike ka nevojë për të qënë e mbrojtur me polici dhe policia ka nevojë të mbrohet nga vetvetja.*

Shteti ligjor e vë theksin tek të drejtat e qytetarëve dhe i ve kufizime iniciativës së zyrtarëve të ligjit, kurse burokracia tek iniciativa dhe efienca. Tensioni që lind midis pasojave që vijnë nga kjo, përbën një problem parimor. Këtë tension, Heindeson e fokuson tek debatet që po bëhen *...rreth krizës në shërbimin modern policor, e cila ka tendencën të zhvillohet rreth çështjeve që lidhen me kontrollin civil mbi policinë (shteti ligjor) dhe përgjegjësi sociale të saj (mbajtja nën kontroll e krimit dhe çrregullimit)*". Heindeson, evidenton pesë modele të reagimit ndaj këtij tensioni, që kur aplikohen sjellin pasoja shumë të ndryshme mbi natyrën e policimit dhe raporteve me komunitetin:

1. Shkarja në shtetin policor

Ose humbja e kontrollit mbi policinë. Policia i merr dhe i aplikon vetë përgjegjësitë e saj. duke synuar të vendosë kontroll të gjithashëm e të centralizuar.

2. Jetërsimi i policisë

"Sindroma Neiderhofer" apo "sindroma e vetizolimit" sikurse e pershkruan A. Neiderhofer, ne librin e tij *"Behind the shield"* (1967) lind tek punonjësit e policisë për shkak të natyrës së punës stresante. Kur kjo sindromë prek gjithë policinë, kur izolimi në vetvete dhe shkëputja nga shoqëria përzgjidhet si modeli i reagimit ndaj problemeve, presioneve dhe qëndrimeve jomiqësore ndaj policisë, ajo veçohet duke u vendosur perballe nje publiku mosbesues.

3. Shërbimi policor komunitar

Thelbësore për të është projektimi i një shërbimi si marrëveshje negociimi dhe partnershipi midis policisë dhe publikut, që mbrojtja e zbatimi i ligjit të jetë një aksion i përbashkët, dhe jo një përgjegjësi që duhet ta përmbushë vetëm policia

4. Shërbimi policor profesionist.

Ky përfshin përmirësimin e shkathhtësive dhe rezultateve me të cilat matet tradicionalisht puna e policisë: zvogëlimin e koeficientit të frekuencës dhe llojshmërisë së krimeve, rritja e forcës zbuluese të policisë sipas prioriteteve dhe një manaxhim i policisë si një ndërmarrje biznesi. Theksi vihet tek profesionalizimi, tek arritja e standardeve profesionale nga të gjithë punonjësit e policies dhe tek rendimenti në punë. Edhe pse është eficient e rentabël, ky model ka prirje tu shmanget respektimit të parimeve të shtetit ligjor, pasi e vë theksin tek arritja e produktit me çdo mjetet, madje duke i'u shmangur kontrollit ligjor dhe detyrimit për të respektuar të drejtat e njeriut.

5. Modeli ligj - rend.

Kjo zgjidhje, edhe pse ka përkrahës në debatin mbi krizën, sipas Heindeson, duket më tepër një skemë e rekomanduar nga masmedia dhe nga pjesa e punonjësve të policisë, që kërkojnë më tepër fuqi ligjore, për mbajtjen nën kontroll të krimit dhe rendit publik.

Policimi komunitar

Mbajtja dhe ruajtja e sigurisë publike është një detyrë dhe proces mjaft më kompleks sesa parandalimi i thjeshtë i krimit, bërja e arrestimeve për shkeljet e ligjit, gjetja e kthimi i sendeve të grabitura apo gjurmimi dhe plotësimi i dosjeve për personat e ngarkuar me përgjegjësi penale apo kontrolli fizik i territorit.

Deri në vitet 80 është dashur të mësohej se policia nuk mund t'i kontrollojë e vetme në mënyrë të efektshme krimin, strukturat kriminale dhe situatat e rrezikshme dhe se parandalimi me anë të shtypjes është pa efekte të dukëshme. Si rrjedhim, forcat e policisë filluan të hartonin plane për vlerësimin e

veprimtarisë në lidhje me krimet e ndodhura dhe me vëzhgimin e aktivitetit të policisë, për të përmirësuar cilësinë e punës së policisë.

Më pas, filloi të bëhej i njohur dhe të përhapej si një orientim i ri për funksionimin e policisë, "Policimi Komunitar". Sot intertesi për të është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe policia në shumë vende ka përpunuar e aplikon forma të larmishme të policimit komunitar:

Lista e programeve dhe shkalla e zbatimit të tyre në raport me totalin e programeve të policimit komunitar të aplikuar nga polici të ndryshme 2004:

1. Edukimi i publikut/ralacionet me Median (98%)
2. Programet e mbrojtjes, mbikqyrjes dhe kontrollit të së lagjeve të banimit (97%)
3. Njësitë e zgjidhjes së problemeve të rëndësishme specifike të komunitetit(91%)
4. Kontrolli i territorit (patrullimi) me këmbë/me kuaj/me biçikleta (88%)
5. Patrullat e policisë me detyra të përqëndruara tek problemet (87%)
6. Takime me banorët e zonave urbane dhe aktivitete argëtimi me të rinjtë e lagjeve (86%)
7. Programet e vullnetarëve ndihmës (68%)
8. Programet e rikontaktit të viktimave (62%)
9. Gazetat, fletpalosjet dhe websitet e policisë për edukimin e komunitetit (49%)
10. Ministacionet e policisë "me vitrina" për pritje dhe kontakt me banorët e lagjes (41%)

Të gjitha programet e policisë komunitare kanë të përbashkëta dy aktivitete kryesore :

1. Ato vendosin lidhje te forta midis policise dhe komunitetit per te bashkerenduar forcimin e ligjit me sherbime te tjera, qe ndikojne ne cilesine e jetes.
2. Ato rrisin aftesine e forcimit te ligjit, ne menyre qe te identifikojne, te analizoje dhe t'u pergjigjet problemeve te komunitetit ne menyre sistematike.

Të dhënat nga kërkimet e bëra në këtë fushë në fund të viteve '80 e më pas, vërtetuan se, lidhjet më të ngushta midis policisë dhe qytetareve, veçanërisht në formën e kontaktit derë-më-derë dhe patrullimit në këmbë, rrisin nivelin e sadsifaksionit të qytetarëve për shërbimet e policisë, përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitet dhe ulin nivelet e frikës nga krimi.

Ç'është "Policimi Komunitar"

Trojanowicz e përshkruan Policimin Komunitar si *..."filozofinë e një policimi që projektohet të jetë plotësisht në shërbim të komunitetit; të personalizuar aq sa të njëjtët punonjës policie, që veprojnë në të njëjtat hapësira komunitare, mbi baza permanente dhe në mënyrë të decentralizuar, punojnë në partnership proaktiv me qytetarët, për të identifikuar dhe zgjidhur sëbashku me ta problemet e ndërsjellta."*

Policimi komunitar konsiston në aranzhimin e dy komponentëve që plotësojnë njeri-tjetrin:

① **partnershipi komunitar**

② **zgjidhja e problemeve.**

Për të ndërtuar partnershipin komunitar, policisë i duhet të krijojë marrëdhënie pozitive me komunitetin, duhet ta përfshijë komunitetin në kërkimin e rrugëve më të mira për parandalimin dhe kontrollin e krimit dhe, më tej, duhet të bashkojë forcat (si një skuadër) dhe burimet e veta me ato të komunitetit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve më urgjente të pjesëtarëve të komunitetit.

Zgjidhja e problemit është procesi përmes të cilit identifikohen shqetësimet specifike sipas komuniteteve dhe përcaktohen mjetet e mënyrat e përshtatëshme të kurimit dhe reduktimit të tyre.

Në një farë mënyre, policimi komunitar përfaqëson një thyerje dhe një shkëputje nga modelet pararendës të policimit, (*psh nga modeli profesionalo-burokratik, teknokratik dhe ligjzbatues*), që e mban policinë larg komunitetit, për faktin se tregohet mjaft i interesuar për të qënë neutral dhe efiçent në përmbushjen e përgjegjësiave. Ky model fokusohet tek bërja e arrestimeve dhe ndalimeve *pas* ndodhjes së krimit. Në kontrast me të, policimi komunitar orvatet të integrojë dhe të fusë policinë brenda komuniteteve, duke inkurajuar punonjësit e policisë ta shohin veten si “avokatët” e komunitetit dhe partnerë në zgjidhjen e problemeve të tij. Këtë rol ata do ta luajnë duke i paraprirë nevojave dhe problemeve të komuniteteve të veçanta dhe duke ndërhyrë për zgjidhjen e tyre (psh, duke ndihmuar keqbërësit potencialë të gjejnë punë ose duke përdorur lobingjet e ndryshme të grupeve të interesit në komunitet e më gjerë, për të ndriçuar rrugët e brendëshme dhe parqet publike). Duke qënë një shndërrim total i policisë, i strukturave, i mënyrave të kryerjes së detyrës dhe i mënyrave të të menduarit, policimi komunitar ka nevojë për një punonjës policie të integruar në jetën e përditëshme të komunitetit (një polic qytetar) dhe për këtë shkak ai duhet përgatitur si një figurë e përgjithëshme dhe jo si një superpolic apo teknopolic të specializuar të veprorë në kushte decentralizimi kompetencash.

Modeli në thelb është një orvatje eksplicite për të krijuar një forcë policie më demokratike. Ai bazohet në parimin se policimi do të jetë më efektiv nëse do të kishte mbështetjen e komunitetit dhe nëse policia do të njohte mirë aspektet e shërbimit social dhe të mbajtjes së qetësisë të rolit të saj. Natyrisht që kjo do të përfshinte edhe çështjet e diskutueshme dhe problematike që i bashkëngjiten proceseve të aplikimit të policimit komunitar si:

1. ajo ç’ka përbën një komunitet (komuniteti ndërtohet mbi bazën e gjeografisë së banimit ose mbi bazën e besimeve, vlerave të përbashkëta dhe mënyrës së përbashkët të jetesës), përballet vazhdimisht me rrezikun që grupet e nëngrupet më të fuqishme të këtij komuniteti, duke u përpjekur të plotësojnë qëllimet e tyre dhe duke e etiketuar veten si “komunitet” lënë pas dore nevojat dhe plotësimin e interesave të grupeve më të vogla ose me më pak influencë.
2. si të përballet dhe të zgjidhet tensioni midis profesionalizmit dhe veprimit të specializuar, pjesmarrjes e gjithëpërfshirjes demokratike të qytetarëve në policim dhe rrezikut që shërbimi policor të tërhiqet e familjarizohet vetëm me segmente të caktuara të komunitetit.

Koncepti “komunitet”

Në raport me nocionin gjeografik të komunitetit, punonjësit e policisë që patrullojnë zonat, janë të parët që kryejnë shërbime ndaj qytetarëve dhe që kanë kontaktet më të gjera e më të shpeshta me ta. Në kuadrin e aplikimit të programeve të policimit komunitar, ata përsëri mbulojnë pjesën më të madhe të nevojave të përditëshme të policimit dhe për këtë ata duhet të ndihmohen jo vetëm nga eprorët e tyre, nga njësi të specializuara të policisë, por edhe nga agjensitë përkatëse shtetërore dhe shoqërore. Nivelet e larta të drejtimit dhe stafet komanduesë të policisë, në këto përpjekje kanë përgjegjësinë të garantojnë mbështetjen e gjithë organizatës dhe burimeve të saj, për shërbimet e policimit komunitar nga punonjësit me uniformë të policisë.

Efektiviteti dhe efiçenca e policimit komunitar varet shumë nga optimizimi i kontakteve pozitive midis punonjësve të policisë së rendit, të inspektorëve të policisë të lagjes dhe pjestarëve të komunitetit. Kontrolli me automjete i territorit është vetëm një metodë patrullimi, në programet e policimit komunitar, dhe nuk ka ndonjë lidhje thelbësore me domethënien e tij. Policia, krahas patrullimit me makina (kur komuniteti gjeografik ka shtrirje të madhe territoriale) plotësohet, mbështetet ose kombinohet edhe me patrullimin me këmbë, me biçikleta etj..

Një kusht i rëndësishëm është mbajtja e qëndrueshmërisë së grupeve policore të kontrollit të territorit. Duke shërbyer për një kohë të gjatë me turne dhe grupe patrullimi, nga njera anë punonjësit e policisë do të jenë figura familjare dhe të afërta për banorët dhe nga ana tjetër do të fitojnë një sens më të fortë të

vetdijes dhe përgjegjësisë për problemet që ka komuniteti dhe që duhet të kujdesen ditë-për-ditë. Kjo rritje e pranisë së policisë në mjediset e banuara, përbën hapin dhe lëvizjen fillestare të stabilizimit të mirëbesimit publik dhe shërben për të zvogëluar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë nga krimi dhe çrregullimet tek pjestarët e komunitetit. Për pasojë, krijimi i një klime të tillë bashkëpunimi dhe gatishmërie rrit ndjeshëm sigurinë dhe qetësinë e banorëve. Frika nga krimi duhet të reduktohet qysh më parë, nëse duam që pjestarët e komunitetit të jenë pjesmarrës aktivë në policim. Njerzit nuk reagojnë nëse ndjejnë se nga këto veprime do të vihej në rrezik siguria dhe jeta e tyre.

Megjithse shërbimet që policia i ofron shoqërisë në përgjithësi dhe komuniteteve në veçanti, janë të organizuara sipas kriterëve gjeografike, komuniteti mund të përfshijë brenda vetes një diversitet të gjerë kulturash, vlerash dhe problemesh, veçanërisht në zonat qytetëse. Komuniteti përbëhet nga më shumë elementë sesa një qeverisje e vetme lokale apo vetëm nga banorët e një lagje. Institucionet e kultit, shkollat, spitalet, grupet sociale, agjensitë private dhe publike dhe të gjithë ata qytetarë që punojnë në një zonë të caktuar administrative, janë antarë vitalë të komunitetit. Më tej akoma, edhe ata qytetarë që vizitojnë zonën e banuar për qëllime kulturore (vizita tek të afërmit, për festa dhe ngjarje), për qëllime argëtimi (vizita në vende turistike, plazhe, kinema, diskoteka, koncerte etj), që kryejnë shërbimet e tyre sociale ose private në hapësirat urbane, janë gjithashtu të interesuar për çështjet e sigurisë dhe të qetësisë në ato zona. Përfshirja e këtyre “komuniteteve të interesit” në përpjekjet e policisë për të përballuar problemet e krimit dhe të çrregullimit, i zgjeron mjaft burimet bazë të saj në komunitet.

Ashtu si komunitetet gjeografike, edhe komunitetet e interesit kanë probleme e prioritete që ndryshojnë nga njeri tek tjetri. Disa janë mjaft të qëndrueshëm dhe formohen rreth linjave etnike, profesionale, rreth një historie të përbashkët, mbi baza besimesh fetare ose politike, etj. Të tjerët formohen dhe riformohen mbi bazën e problemeve të reja, që u lindin ose u drejtohen bashkërisht për t’i zgjidhur. Grupet e interesit brenda komunitetit mund të jenë në konflikte ose të kenë mosmarrëveshje midis tyre, disa herë edhe të dhunëshme. Grindjet, mosmarrëveshjet dhe konfliktet intrakomunitare janë mjaft të shpeshta në qendrat e mëdha urbane (qytetëse), sidomos në periudhat e ndryshimeve demografike dhe zhvendosjeve të popullsisë nga fshati drejt qyteteve.

Qytetarët dhe policët

Interesat shumëfishe dhe shpesh konfliktuale, kërkojnë që punonjësit e policisë që veprojnë dhe shërbejnë në zona të tilla jo vetëm të kenë aftësitë dhe paisjet e duhura për të mbajtur rendin e qetësinë dhe për të zbatuar ligjin, por edhe aftësi të mira si mediatorë dhe pajtues të konflikteve. Nga ana tjetër kërkesat që i bëhen policisë nga një prej komuniteteve të interesit mund të bjerë ndesh dhe të shkelë interesat dhe të drejtat e një komuniteti tjetër interesash. Ndonjë grup komunitar (psh komuniteti i gazetarëve) mund t’u kundërvihet disa taktikave që përdor policia për të kontrolluar me masa energjike sjelljet kolektive të protestës publike, ngaqë mendon se ato mund të çojnë në praktika diskriminuese dhe paragjyquese ndalimi e shoqërimi. Policia duhet jo vetëm të mbrojë të drejtat e grupeve që protestojnë, por ajo gjithashtu duhet të bashkëveprojë me të gjithë pjestarët e komunitetit, për t’i përfshirë në gjetjen e mënyrave dhe rrugëve të përshtatëshme që jo vetëm të realizojnë të drejtat e tyre të protestës, por edhe të mbrohet rendi e qetësia e tërë zonës së banuar nga bashkësia e komuniteteve të interesit. Për ta bërë të suksesshëm dhe efikas këtë proces, pjestarët e komunitetit përcjellin tek strukturat zyrtare të policisë pikpamjet dhe sugjerimet e tyre dhe mbështesin përpjekjet e përfaqësuesve të saj në vendosjen e autoritetit të ligjit në atë zonë. Kjo garanton jo vetëm një pjesmarrje të gjerë të komunitetit dhe të qytetarëve në këtë proces, por ndihmon për të mbajtur një nivel të pranueshëm të rendit dhe qetësisë. Nga ana e saj, policia inkurajon çdo prirje dhe ofertë për bashkëpunim nga kushdoqoftë në komunitet, që ndihmon në mbajtjen në ekuilibër të interesave kolektive të të gjithë qytetarëve me të drejtat personale të çdo individi.

Konfliktet brenda komuniteteve janë sa të rëndësishme, aq dhe të zakonëshme; sa shkaktojnë probleme të mbarëvajtjes së jetës, aq edhe ndodhin për shkaqe nga më të rëndomtë. Policia dhe punonjësit e saj duhet ta njohin mirë këtë ekuacion, për të ndërtuar lidhje të domosdoshme bashkëpunuese në mbajtjen e rendit, në garantimin e ndjenjës së sigurisë dhe në kontrollin e krimit..

Komponenti 1- Partnershipi komunitar

Vendosja dhe mbajtja e mirëbesimit të ndërsjelltë polici-komunitet është objektivi qendror i komponentit të parë të policimit komunitar – i partnershipit me komunitetin. Tashmë policia e njëj mirë nevojën e bashkëpunimit me komunitetin. Përvoja më e përparuar dhe studimet e shumta kanë treguar se në luftën kundër krimeve të rënda, madje edhe kundër krimit të organizuar, informacionet që vijnë nga qytetarët pjestarë të komunitetit rreth veprimeve kriminale kanë qënë gjithmonë një ndihmë e madhe në arritjen e suksesit të policisë. Për këtë arsye policia jo vetëm e inkurajon një prurje të tillë, por në kuadrin e partnershipit i edukon qytetarët si të dallojnë dhe të përzgjedhin informacioni më relevant e të dobishëm. Ajo bën këtë në një larmi programesh dhe metodash, që fillojnë nga bisedat e takimet me grupe banorësh, me pjesmarrje në ngjarje të rëndësishme dhe në festa civile, duke punuar me agjensitë e përkrahjes sociale dhe të shëndetit publik, deri tek pjesmarrja e përfshirja e punonjësve dhe specialistëve të saj në programet edukative-argëtuese për fëmijët dhe të rinjtë nëpër shkolla. Sipas problemeve të komunitetit, duke bashkëpunuar edhe me shoqata e organizata jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e përmirësimit të cilësisë së jetës së përbashkët (psh me OJF-të), policia cakton punonjës ose ngre njësi speciale të saj, për të ndihmuar komunitetin me shërbime të posaçme të ndërhyrjes në kriza..

Partnershipi me komunitetin nënkupton adoptimin e një këndvështrimi të policimit, që i tejkalon thekset standarde të zbatimit të ligjit. Ky zgjerim i botkuptimit pranon vlerën e veprimeve policore që kontribuojnë në përmirësimin e mbarëvajtjes së punësve dhe të rregullit edhe në një zonë të vetme banimi, ashtu siç e perceptojnë banorët. Veprime të tilla përfshijnë një gamë shërbimesh policore, më të gjerë se veprimet e zakonëshme: dhënie ndihme në raste aksidentesh ose për viktimat e krimit, në raste emergjencash shëndetësore, për të zgjidhur e pajtuar konfliktet familjare dhe në lagje (psh, në raste të dhunës brenda familjes, në grindjet e mosmarrëveshjet qiradhënës-qiramarrës, në konfliktet e pronës, në rastet e ngacmimeve racore etj), puna me banorët dhe bizneset lokale për të përmirësuar kushtet e jetesës në blloqet dhe qendrat e banimit (pastrimet e mjediseve të përbashkëta, ndriçimi i rrugëve të brendëshme, sigurimin e shtëpive, për vetmbrojtjen nga viktimizimi dhe grabitjet etj), kontrolli i trafikut të këmbësorëve dhe mjeteve, kryerja e shërbimeve sociale të emergjencës dhe këshillimit për personat në rrezik (psh adoleshentët që largohen nga shtëpia, të pastrehët, përdoruesit e drogës, të sëmurët mendorë), mbrojtja e ushtrimit të të drejtave kushtetuese dhe prezantimi prej punonjësve të policisë i një modeli të sjelljes qytetare e morale.

Shërbime të tilla janë të dobishme për të ndërtuar ura të qëndrueshme e të ndërsjellta të mirëbesimit dhe një imazh publik pozitiv. Besimi i publikut është çelsi që i hap derën policisë ndaj informacionit të çmueshëm të qytetarëve, për të shkuar tek zgjidhja dhe prandalimi i krimit, që e furnizon me mbështetjen e domosdoshme qytetare në masat e mbajtjes nën kontroll të krimit dhe do të rriste ndjeshëm pranueshmërinë publike të punonjësit të policisë në komunitet. Kjo nuk mund të arrihet vetëm nga punonjës të veçantë apo nga specialistët e marrëdhënieve me publikun, por tërë piramida e organizatës policore, nga maja deri në bazë, duhet të përfshihet në procesin e bashkëpunimit me komunitetin.

Vënia në lëvizje dhe aktivizimi i mbështetjes komunitare nuk është një proces që zhvillohet në një vijë të drejtë. Ai kërkon përdorimin e këndvështrimeve dhe metodave të ndryshme për komunitete të ndryshme. Kështu vendosja dhe arritja e bashkëpunimit polici-komunitet është më e lehtë në komunitetet e përbëra nga pjestarë të klasave të mesme dhe të pasura të shoqërisë, në krahasim me ato që përbëhen nga shtresat e varfëra dhe të marginalizuara të shoqërisë, në të cilat mungesa e besimit ndaj policisë ka një

histori kontaktesh të pakëndëshme. Ka gjithashtu dallime midis komuniteteve gjeografike me homogjenitet kulturor siç janë komunitetet rurale apo lagjet me banorë autoktonë në zonat urbane, në të cilat policia dhe strukturat e saj të specializuara e kanë më të lehtë të gjejnë partnerët lokalë, në krahasim me zonat multikulturore të periferisë së qyteteve të mëdha, në të cilat banorët e ardhur rishtaz kanë lidhje të pakta, ndërkohë që instituconet bazë komunitare nuk janë krijuar e konsoliduar në atë shkallë sa të lozin rolin e partnerit me policinë. Në lagje të tilla, lidhjet sociale komunitare dobësohen (madje pengohen) edhe për shkak të përhapjes dhe terrenit të favorshëm që gjen krimi dhe çrregullimi. Ndërtimi i lidhjeve të bashkëpunimit në to, ka nevojë të paraprihet nga ndihma që duhet të japë policia në rindërtimin e këtyre lidhjeve të dobësuar në dy drejtime kryesore: ① përmes masave energjike të luftës kundër krimit dhe çrregullimit dhe ② përmes përkrahjes, mbështetjes dhe mbrojtjes së veprimtarive të institucioneve sociale bazë në këto komunitete (psh, të familjeve, institucioneve të kultit, shkollave etj). Duke u zhvendosur drejt policimit komunitar, policia, përveç detyreve të veta ligjore, luan edhe rolin e katalizatorit dhe lehtësuesit të zhvillimit të komunitetit

Komponenti 2- Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve është një term i gjerë, që nënkupton shumë më tepër sesa një eliminim apo parandalimin të thjeshtë të krimit. Ky komponent themelor i policimit komunitar bazohet në supozimin se “krimi dhe çrregullimi mund të reduktohen me sukses në zonat e vogla të banuara me anën e një studimi të kujdesëshëm të karakteristikave të problemit në atë zonë dhe të aplikimit të burimeve të përshtatshme” dhe mbi supozimin se “qytetarët i përzgjedhin alternativat e tyre mbi bazën e mundësive që u paraqiten, mbi bazën e karakteristikave imediate fizike dhe sociale të zonës ku banojnë. Duke manipuluar me këta faktorë, njerzit do të kenë më pak prirje për të vepruar në mënyra agresive dhe të paligjshme”

Procesi i zgjidhjes së problemit shpjegohet duke ju referuar teorisë që qëndron prapa policimit problemor. Ajo është mjaft e thjeshtë: janë rrethanat dhe kushtet bazë që i krijojnë problemet. Këto kushte e rrethana mund të përfshijnë karakteristikat e njerzve që marrin pjesë në një ngjarje (shkelsit e ligjit, viktimat etj), mjedisi dhe sfondi social në të cilin hyjnë në bashkëveprim dhe marrëdhënie njerzve, mjedisi fizik dhe mënyrat me të cilat publiku dhe opinioni publik i trajton këto kushte dhe rrethana. Një problem që krijohet nga këto kushte e rrethana mund të çojë në një ose disa ngjarje e shkelje të ligjit.

Këto shkelje, sado që rrjedhin nga të njëjtat kushte apo rrethana mund të duken sikur janë të ndryshme nga njera tjetra apo sikur nuk kanë lidhje me njera tjetrën. Për shëmbull, kushtet sociale dhe fizike të një kompleks të dëmtuar dhe të pabanueshëm apartamentesh mund të nxisin grabitje, veprime të rrugaçerisë dhe vandalizmit, ngacmime dhe kanosje ndaj kalimtarëve prej adoleshentëve poterehijni dhe keqbërje të tjera. Këto shkelje të ligjit, për disa prej të cilave mund të marrë dijeni edhe policia, janë simptomat e problemit dhe do të vazhdojnë përderisa problemi që i shkakton nuk do të zgjidhet. Që procesi të funksionojë me sukses i kushtohet vëmendje dhe shqyrtohet bazueshmëria ligjore e shqetësimeve të komunitetit.

Grupet e banorëve dhe punonjësit e policisë mund të mos jenë gjithmonë dakord lidhur me faktin se cili problem do të jetë prioritar. Psh, policia mund të jetë e mendimit se grabitjet me dhunë janë problemi më shqetësues, ndërkohë që banorët konsiderojnë shqetësim të pastrehët që flenë nëpër korridorët e pallateve, vjedhësit e kapakëve të pusetave, thyerjen e xhamave, hedhjen e mbeturinave nga dritaret apo ata që kërkojnë nëpër kazanët e plehrave.

Natyra e problemeve të komunitetit varion dhe përfshin një numur ngjarjesh të lidhura me faktorë si gjeografia, koha, viktimat, autorët e krimeve dhe mjedisi. Këto mund të jenë probleme specifike për një zonë të vogël, për të gjithë komunitetin ose për disa komunitete. Disa prej tyre mund të jenë:

- Rritja e pazakontë e numurit të grabitjeve në një zonë të banuar apo në autobusat urbanë të një linje

të caktuar, krijon një atmosferë ankthi dhe frike tek qytetarët edhe në zona të tjera

- Rritja e numurit të lypsarëve dhe hyrja e tyre nëpër lokale, krijojnë frikë në komunitetet e biznesit.
- Prania e prostitutave nëpër parkime, lulishte dhe ndërtesa të braktisura, apo nëpër rrugët e brendëshme të blloqeve të banimit është gjithmonë një shqetësim për banorët dhe familjarët.
- Prania e të rinjve që mbildhen rregullisht dhe lozin nëpër sheshet e lagjeve duke bërë zhurmë e potere gjer në orët e vona të natës apo që ngrejnë pa masë volumin e kasetofonëve të makinave.
- Prania në komunitet e individëve që u bien në qafë dhe provokojnë banorët, kur janë në gjëndje të dehur apo janë të sëmurë mendorë.
- Prania e shpërndarësve të drogës në afërsitë e shkollave gjatë orëve të pushimeve apo e të rinjve, që ngacmojnë vajzat e shkollës; përbëjnë shqetësim të vazdueshëm për komunitetet.

Proçesi i vënies në jetë të filozofisë

Policimi komunitar, është në thelb proçesi i zgjidhjes së këtyre problemeve nga policia dhe komuniteti. Ky proçes përfshin:

- **Eliminimi tërësisht i problemit.** është zgjidhje e kufizuar në problemet e çrregullimit, psh eliminimi i ngjeshjeve të trafikut duke vendosur shenja rrugore, duke prishur apo rehabilituar ndërtesat e braktisura që ushqejnë një atmosferë nxitëse për krimet.
- **Reduktimi i frekuencës** të problemit. Shpërndarja e drogës dhe problemet që e shoqërojnë si plaçkitjet apo dhunën në grupet e të rinjve do të zvogëlohen nëse komuniteti bashkëpunon me policinë për të ndërtuar dhe vënë në efikasitet qendrat e këshillimit dhe të rehabilitimit. Psh zgjidhje e qëndrueshme është intensifikimi i edukimit “stop drogës” në shkolla, në institucionet e kultit dhe në spitale nga punonjës të specializuar të policisë.
- **Zvogëlimi i shkallës së dëmtimit** nga aksidentet dhe aktet kriminale. Përshëmbull, policia mund të mësojë punonjësve në dyqane e magazina si të veprojnë gjatë një grabitje, që të shmangin plagosjen apo vrasjen nga grabitësit, ose këshillon femrat (në lagje, në shkolla etj) për mënyrat e minimizimit të mundësive për të mbetur të vrara ose të dëmtuara seriozisht, nëse i sulmojnë.
- **Përmirësimi i trajtimit të problemeve.** Policia duhet të bëjë përpjekje për t’i trajtuar njerzit në mënyrë humane, (psh., të tregojë ndjeshmëri dhe dhëmshuri ndaj viktimave të grabitjeve dhe përdhunimeve, duke kërkuar mënyrat më të mira të trajtimit të traumave të tyre, të rrisë efektivitetin e saj në trajtimin e adoleshentëve që largohen nga shtëpia, të përdoruesve të drogës, të personave që drejtojnë automjetet të dehur etj, duke bashkëpunuar me institucionet e specializuara).
- **Manipulimi i faktorëve mjedisorë për të dekurajuar sjelljet kriminale.** Kjo formë problemzgjdhëse, mund të përfshijë gjer edhe përpjekjet për të ndikuar në organet e pushtetit vendor në përmirësimin e ndirçimit të rrugëve brenda lagjeve, në pastrimin e zonave të banuara nga bimësia e egër, rregullimin e shkurnajave nëpër periferitë publike dhe plumbosje e ndërtesave bosh.

Përfundime

1. Të gjitha nivelet e strukturës organizative të policisë duhet të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, në vartësi të qëllimit, të rëndësisë dhe të shtrirjes së problemit. Përshëmbull, gjetja e një zgjidhje për rastet e keqtrajtimit dhe plagosjes nga bashkëshortët, mund të kërkojë përfshirjen e disa niveleve të hierarkisë së policisë. Inspektori i policisë i lagjes apo inspektorët e policisë kriminale mund të evidentojnë se keqtrajtimet dhe plagosjet kanë ardhur si pasojë e problemeve familjare dhe e tepërimit me alkollin nga autorët, veçanërisht në klubet e natës dhe lokalet e paligjëshme.
2. Reformat në çdo polici duhet të sigurojnë mjetet dhe njohuritë për të shkatërruar rrethin e burokratizimit dhe teknokratizmit. Shkëmbimi institucional i përvojve midis policive në mbarë botën

mbështet realisht procesin e tranzicionit tek ato forca policore, që po transformohen në shërbime publike dhe akoma më tepër në policinë e vendeve të dala nga diktaturat. Çdonjeri mund dhe duhet të mësojë nga të tjerët; askush nuk e zotëron monopolin e dijes dhe të së vërtetës.

3. Ajo që tërheq vëmendjen në thënien e Skolnick, se “çështja e policisë në ditët e sotme nuk është pajisja e saj me teknologji, mjete e makina, por ndryshimi rrënjësor në mënyrën e të menduarit dhe të kryerjes së detyrave”, përmbledhet me dy fjalë nga fjala e urtë gjermane e përdorur nga Thomas Feltes: “Një injorant me një vegël pune moderne në dorë, mbetet përsëri një injorant”. Një nga detyrat më të rëndësishme të liderit të policisë është padyshim përcaktimi dhe trupëzimi tek vartësit e tyre të standardeve të larta të sjelljes profesionale dhe të garantojë, pa përjashtim, që çdo punonjës të manifestojë sjellje të tilla.

Ndërtimi dhe vënia në efikasitet e standardeve profesionale dhe etike të policimit demokratik, nuk është detyrë që mund të nënvleftësohet, por është ndoshta më prioritare sesa një plan apo një strategji disavjeçare e modernizimit të pajisjeve dhe teknologjisë së policimit. Një punonjës policie, përpara se të përgatitet për të mësuar programet kompjuterike apo përdorimin e pajisjeve moderne të zbulimit të drogës dhe ADN, duhet të jetë i mirëpajisur me standardet profesionale të sjelljes, me aftësitë e komunikimit me grupet dhe individët brenda policisë dhe qytetarët, me aftësitë e ndërmjetësimit, të këshillimit social dhe të punuarit me të tjerët. Një reformë dhe një stërvitje, që siguron vetëm mjetet apo përdorimin e metodave e teknikave, pa shpërndarë filozofinë dhe moralin e nevojshëm, pa përcjellë njohjen dhe të kuptuarin e rolit, si punonjës i policisë dhe njëkohësisht si pjesë përbërëse e komunitetit, jo vetëm nuk është e dobishme, por përkundrazi, është e rrezikshme për shoqëritë demokratike.

4. Policia dhe komuniteti bëhen partnerë në përballimin e problemeve që lidhen me çrregullimin dhe braktisjen (psh me veprimet e rrugaçerisë, braktisjen e karkasave të automjeteve dhe pajisjeve elektroshtëpiake, etj) që ndonjëherë nuk janë ende veprime kriminale ose kundravajtje, mund të çojnë në veprime ose pasojë të rrezikshme..
5. Informacioni i dobishëm nga antarët e komunitetit drejt policisë, do të rrjedhë vetëm kur të vendosen marrëdhëniet e duhura të besimit të ndërsjelltë midis tyre. Arritja e kësaj klime mirëbesimi do kohë të realizohet, veçanërisht në komunitetet që kanë konflikte të brendshme intersash apo aty ku marrëdhëniet e policisë me qytetarët janë dëmtuar seriozisht për shkak të tensioneve dhe keqjelljeve të punonjësve të veçantë të policisë. Policimi komunitar ofron një mënyrë të dobishme dhe efektive për të bërë të mundur që policia dhe qytetarët të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet. Vetëm kur banorët e një komuniteti besojnë dhe shohin se policia është seriozisht e përkushtuar për të realizuar policimin komunitar dhe për të zgjidhur problemet, do të nisnin ta shohin policinë dhe punonjësit e saj, si pjesë e komunitetit.

Dështimi në organizimin dhe aplikimin e projekteve dhe në mbajtjen e këtyre standardeve nga çdo punonjës policie do të sillte dëme të pallogaritshme, jo vetëm në çënimin e respektit dhe mirëbesimit, por më tepër se kaq në shkatërimin e mundësive për të aplikuar policimin komunitar në ato komunitete për një kohë mjaft të gjatë.

Pa këtë besim reciprok, policimi komunitar do të ishte vetëm një utopi boshe.